



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2069/8 prot.

Datë 29.08.2024

V E N D I M
Nr. 1129/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Horieti” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09408-06-13-2024, me objekt: “Blerje materiale te ndryshme per lyerje dhe sherbetime te objekteve arsimore ne bashki + njesi administrative per vitin shkollor 2023-2024”, me fond limit 3,303,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Ankimues: “Bajro Bros” SHPK me NIPT M113130290 dhe adresë: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Librazhd me adresë: Sheshi “Gjorg Golemi” Librazhd

Subjekt i Interesuar: Subjekte të Interesuara: “Gentian Horieti” P.F. me NIPT K31427013J dhe adresë: 5 MAJI ISH NPK, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit

publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09408-06-13-2024, me objekt: “Blerje materiale te ndryshme per lyerje dhe sherbetime te objekteve arsimore ne bashki + njesi administrative per vitin shkollor 2023-2024”, me fond limit 3,303,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 26.06.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 17.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “GENTIAN HORIETI” P.F,	1,958,700	lekë	kualifikuar
-” BAJRO BROS SHPK,	2 477 250	leke	kualifikuar
- “T&J Construction” shpk ,	2 571 200	leke	kualifikuar
- “ AGIM HAZIZI "P.F	2 765 340	leke	kualifikuar
- “LLUCA” SH.P.K	2 893 800	leke	kualifikuar

II.4. Në datën 22.07.2024, është publikuar në SPE, Njoftimit i Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Me datën 24.07.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4374, si dhe nr. protokollit 2069/2024 datë 24.07.2024 e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Gentian Horieti P.F në procedurën e prokurimit konkretisht duke pretenduar se: *“Oferta e OE “Gentian Horieti” P.F është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO-ja përkatëse, duhet të zbatonte ndryshimet ligjore të datës 08.02.2024, nenin 27 të Ligjit 16/2024, në të cilin thuhet: “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.2069/2 prot., datë 25.07.2024.

II.7. Me datë 31.07.2024 është ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimi i autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës i cili u protokollua me tonën me nr. 2069/3 prot., datë 31.07.2024 ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën duke argumentuar: *“Argumentimi ligjor Sipas nenit 93 te LPP-së, një ofertë që konsiderohet anomalisht e ulët mund të skualifikohet vetëm nëse pas kërimit të shpjegimeve, këto të fundit nuk janë të mjaftueshme ose bindëse. Në rastin konkret, shpjegimet e operatorit ekonomik janë konsideruar të plota dhe të bazuara. Gjithashtu, referuar praktikave të Bashkimit Evropian, një ofertë nuk mund të*

skualifikohet automatikisht për shkak të një çmimi të ulët pa një shqyrtim të thelluar dhe kërkim të shpjegimeve nga ofertuesi. Praktika gjyqësore e BE-së (jurisprudenca e saj) thekson rëndësinë e një analize të kujdesshme përpara marrjes së një vendimi të tillë.

Për sa më sipër, argumentojmë se oferta e OE "GENTIAN HORIETI" P.F nuk duhet të skualifikohet për shkak se është bindëse në shpjegimet e dhëna dhe nuk përbën një rrezik për realizimin e kontratës. LPP-ja nënvijëzon rëndësinë e ruajtjes së parimeve të transparencës dhe konkurrencës së ndershme në proceset e prokurimit. Refuzimi i ofertës më të ulët pa kërkuar shpjegime bie ndesh me këto parime, duke dëmtuar integritetin dhe drejtësinë e procesit të prokurimit.

Fillimisht për të përcaktuar nëse një oferte është apo jo anomalisht e ulët duhet të vërtetohet nëse kjo oferte është e përgjegjshme dhe nuk rrezikon AK në përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Për ne si AK vlerësohet se çdo ofertë duhet të vlerësohet në mënyrë objektive dhe të ndershme, duke u dhënë mundësi të barabarta të gjithë pjesëmarrësve.

LPP-ja synon të sigurojë që fondet publike të shpenzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Duke refuzuar ofertën më të ulët pa kërkuar shpjegime, autoriteti kontraktor mund të shkaktojë një humbje të mundshme të fondeve publike, duke mos përfutur nga një ofertë ekonomikisht e leverdishme.

Referuar nenit 93 vërejmë se kemi dy tipologji Ofertash anomalisht të Ulëta: 1) Rastet Kur Duhet Trajtuar (Kërkohen Shpjegime) dhe 2) Rastet kur refuzohet pa kërkuar shpjegime. Neni 93 përmend dy terma "vërehet OAU" që parashikohet në pikën 1 dhe "konstaton OAU" e përmendur në pikën 5. KVO thekson se ndërmjet këtyre dy termave ka dallim nga pikëpamja juridike:

Termi "Vihet re një ofertë anomalisht e ulët" në vlerësimin tone është faza ku autoriteti kontraktor identifikon një ofertë dukshëm më të ulët se të tjerat ose se çmimet e tregut. Në këtë rast Autoriteti kërkon shpjegime nga ofertuesi për çmimet e ulëta, të cilat mund të përfshijnë efikasitetet e prodhimit, kushtet favorizuese, teknologjinë e avancuar, etj. Pas marrjes së shpjegimeve, autoriteti i shqyrton për të vendosur nëse oferta është e justifikuar.

Ndërsa termi "Konstatohet oferta anomalisht e ulët": Në vlerësimin tone është një e drejtë që LPP i jep AK që për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, për të refuzuar një ofertë anomalisht të ulët pa kërkuar shpjegime të tjera. Në rast se kjo oferte përfaqëson prima facie një oferte që tregon riskun e madh që i transferohet AK. Në çdo rast ky është një vendim i bazuar në vlerësimin paraprak dhe legjislacionin përkatës. Në këtë këndvështrim AK vlerëson se nga tërësia e të dhënave që ofron OE i renditur i pari provon se ka besueshmërinë, përvojën, kapacitetet dhe çmimet konkurruese për shkak të përvojës së tij në tregtimin me shumicë dhe gjendjes stok të mallrave kryesor që janë objekt i kësaj procedure prokurimi për të dhënë një oferte të leverdishme/ të përgjegjshme për ne si AK.

Në përfundim, mbështetur në nenin 93 të LPP-së, RRPP-se dhe referuar praktikave të BE-së, vlerësojmë se i KVO-së është në përputhje me 87, 97 të LPP-se dhe RRPP-se ka konsideruar këtë oferte të vlefshme dhe rrjedhimisht të klasifikohet si oferta e pare. Bazuar në këtë argument vlerësojmë se ankesa e paraqitur nga "OE BAJRO BROS" shpik është e pabazuar në ligj dhe në prova.

Per sa me sipër;

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendos:

- *Mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “BAJRO BROS “ shpk,*

II.8. Me shkresën me nr. 3938 prot., datë 19.08.2024 protokolluar me tonën me nr. 2069/5 prot., datë 20.08.2024 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshejtimin e vendimmarrjes në lidhje me trajtimin e ankesës për procedurën konkrete të prokurimit.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Bajro Bros” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F me pretendimin se: *“Oferta e OE “Gentian Horieti” P.F është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO-ja përkatëse, duhet të zbatonte ndryshimet ligjore të datës 08.02.2024, nenin 27 të Ligjit 16/2024, në të cilin thuhet: “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta e tij ekonomike në vlerën prej 1,958,700 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në

argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët.

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5, të nenit 93 të LPP-së në të cilin përcaktohet se: *‘në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët’*, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi e ka fondin limit 3,303,000.00 lekë, vlerë e cila rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 1 ku përcaktohet se: *1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Gentian Horieti P.F është i pa drejtë, pasi ndryshimet e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kanë hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, ndërkohë që urdhri i prokurimit për procedurën e mësipërme të prokurimit mban datën 13.06.2024, ndaj për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët pa kërkuar shpjegime. Në rastin konkret duke qenë se procedura e prokurimit është me vlerë nën kufirin e lartë monetar, vendimi i KVO së autoriteti kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F e cila në aplikim të formulës rezulton anomalisht e ulët është një vendim i cili vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe si i tillë është një akt administrativ i pavlefshëm. Autoriteti kontraktor duhet të skualifikonte ofertën e operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F e cila në aplikim të formulës rezulton anomalisht e ulët pa kërkuar shpjegime. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet, se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë

palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, konstaton, se vendimi i KVO së autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertë së operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F kur ndodhet në kushtet e parashikuara nga nenin 93 pika 5 e LPP-së, është akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A i cili si një akt administrativ individual, i shtrin efektet inter parties dhe në asnjë rast erga ommnes. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt - prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014, datë 17.03.2014, është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia në vendimin 15/2010 ka theksuar se “parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkalar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”. Sa më sipër, KPP, gjykon, se vendimi i KVO-së për kualifikimin e oferës së operatorit ekonomik Gentian Horieti P.F e cila është ofertë anomalisht e ulët dhe procedura e prokurimit është nën kufirimin e lartë monetar është në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, ndaj duhet të anulohen si vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “Bajro Bros” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e

rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09408-06-13-2024, me objekt: “Blerje materiale te ndryshme per lysterje dhe sherbetime te objekteve arsimore ne bashki + njesi administrative per vitin shkollor 2023-2024”, me fond limit 3,303,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Gentian Horieti P.f, duke e skualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

